

VENDIM
Nr. 240, datë 21.12.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERDY ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “KALIS” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2138 kw

(Ndryshuar me vendimin nr. 219, datë 1.9.2022; nr. 224, datë 30.9.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/10 prot., datë 16.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 205, datë 4.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Kalis”, me vendndodhje në përroin e Shmilit, Kuterman, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/42 prot., datë 4.12.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1232/1 prot., datë 11.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1232/2 prot., datë 14.12.2020, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi, në respektim të rregullores sipërcituar, është tërësisht i plotësuar.

Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd (datë 21.9.2025) shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Shoqëria, pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullësor publik të sipërfaqes së përcaktuar më sipër, duhet ta depozitojë atë në ERE.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 25.4.2022) shoqëria të depozitojë në ERE të rifreskuar në datë, jo më vonë se një muaj pas rinovimit të afatit të saj.

- Kontrata nr. 1945 rep., nr. 885/3 kol., datë 4.9.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Kalis’, me kapacitet prodhues 1958 kw, në ujërat rrjedhës të lumit të Shmilit, dege e Lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, e lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë

elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Erdy Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kalis”, me kapacitet të instaluar 2138 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. *Shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, jo më vonë se data 4.7.2027.*

5. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti